



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN**  
**E TË DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 872/1 prot.

Tiranë më 08.04.2026

Lënda: Mendim mbi projektvendimin “Për bazën e të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar”

**MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT**

**Tiranë**

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj me nr. 2475 prot., datë 25.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 872 prot., datë 27.03.2026, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin “Për bazën e të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar”, së bashku me relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i projektvendimit dhe relacionit shoqërues konstatohet se ai parashikon krijimin e një baze të dhënash që përfshin, ndër të tjera, edhe kërkesat për strehim social të depozituara pranë autoriteteve vendore. Në këtë kuadër, vlerësohet se, krahas të dhënave teknike dhe statistikore, mund të përpunohen edhe të dhëna personale të individëve aplikues/përfitues, çka kërkon saktësimin dhe plotësimin e disa dispozitave për garantimin e përputhshmërisë me ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “Ligji”).

Nga analiza e projektvendimit vërehet se, në pikën 1 të tij, parashikohet publikimi i përmbajtjes së bazës së të dhënave në faqen e internetit nga organet përkatëse, pa u specifikuar qartë kufizimet mbi kategoritë e të dhënave që mund të bëhen publike. Kështu sugjerojmë që **në pikën 1 të projektvendimit**, në fund të fjalisë së fundit që lidhet me publikimin e të dhënave, të shtohet togfjalëshi “...në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në vijim, në germën b) të pikës 7, të projektvendimit është parashikuar se baza e të dhënave e strehimit social do të ndërveprojë me sisteme të tjera si REVALB dhe ROMALB, por nuk përcaktohen qartë kushtet dhe kriteret e këtij ndërveprimi. Zyra e Komisionerit vlerëson se ndërveprimi i këtij sistemi me sisteme të palëve të treta legjitimohet vetëm nëse është i parashikuar në legjislacionin specifik dhe në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave, të parashikuara në nenet 6 dhe 7 të Ligjit. Për këtë arsye, sugjerojmë që **pas pikës 8 të projektvendimit të shtohet një paragraf** me këtë

përmbajtje: “*Shkëmbimi dhe ndërveprimi i të dhënave personale me sisteme të tjera kryhet vetëm për aq sa është i domosdoshëm për realizimin e qëllimeve të përcaktuara, në përputhje me bazën ligjore përkatëse dhe duke garantuar respektimin e parimeve të përpunimit dhe sigurinë e të dhënave personale*”.

Sa i takon sigurisë së të dhënave personale, projektvendimi nuk parashikon në mënyrë të qartë masa teknike dhe organizative për mbrojtjen e tyre nga përpunimi i paautorizuar ose i paligjshëm. Në këtë drejtim, në përputhje me nenin 28 të Ligjit, sugjerojmë që ***pas pikës 9 të projektvendimit të shtohet një paragraf*** me këtë përmbajtje: “*Institucionet përgjegjëse zbatojnë masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut, për çdo veprim në sistem lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin apo përhapjen e të dhënave personale, duke garantuar gjurmueshmërinë, konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e tyre, si dhe regjistrimin dhe monitorimin e aksesit në sistem*”

***Në pikën 11 të projektvendimit*** togfjalëshi “... për të dhënat personale” të zëvendësohet me togfjalëshin “...për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në përfundim, me përfshirjen e sugjerimeve të mësipërme, Zyra e Komisionerit vlerëson se projektvendimi është hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**